

# STATISTIKAT E BLEGTORISË

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

## Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	6
11. Menaxhimi i cilësisë .....	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	8
15. Kohëzotuesia dhe Krahueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor .....	10
19. Komente.....	10
Aneks .....	10

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.
1.3. Personi i kontaktit	Erinda Sulstarova
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjësi Sektorit, Sektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:esulstarova@instat.gov.al">esulstarova@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+355 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	21.06.2024
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	21.06.2024
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	21.06.2024
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Statistikat e blegtorisë ofrojnë informacion të detajuar, për numrin e krerëve të bagëtive sipas llojit dhe kategorive (gjedhë, të leshta, të dhirta, derra, njëthundrakë, shpendë dhe bletaria). Prodhimet blegtorale përfshijnë prodhimin e qumështit sipas llojeve lope, dele dhe dhie. Të tjera prodhime blegtorale përfshijnë prodhimin e leshit, vezëve dhe mjaltit.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi i përdorur në Statistikat e Blegtorisë i referohet klasifikimeve dhe përkufizimeve sipas rregulloreve përkatëse të BE-së. <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Rregullorja Nr. 1165/2008</a> në lidhje me statistikat e blegtorisë dhe mishit;</li> <li>• <a href="#">Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1242/2008</a> mbi tipologjinë e njësive Bujqësore;</li> <li>• <a href="#">NACE Rev.2</a> - Klasifikimi statistikor i veprimtarive ekonomike.</li> </ul>

<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Informacioni statistikor mblidhet nga Njësitë Ekonomike Bujqësore që operojnë në aktivitetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Seksionin A - Bujqësia, pemtaria dhe peshkimi - Grupi: 01.4 Blegtoria;</li> <li>• Seksionin C - Grupi 10.1: Prodhimi dhe përpunimi i mishit dhe produkteve me bazë mishi.</li> </ul> <p>Ky informacion mbulon të dhëna mbi numrin e krerëve dhe prodhimet blegtorale në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Blegtoria dhe shpendët mbulojnë të gjitha kafshët pavarësisht nga mosha, vendndodhja ose qëllimi i tyre për mbarështim. Kafshët mund të jenë prezent në Njësinë Ekonomike Bujqësore, ose jashtë fermave bujqësore në kullotë.</p> <p><b>Njësia ekonomike bujqësore-blegtorale:</b> është njësi tekniko-ekonomike nën një drejtim të vetëm dhe mbarështon kafshë si gjedhë, të leshta, të dhirta, derra, shpendë dhe bletë.</p> <p><b>Gjedhë:</b> nënkupton kafshët shtëpiake të species <i>Bos taurus</i> dhe <i>Bubalus bubalis</i>, duke përfshirë hibridët e tillë si Beefalo.</p> <p><b>Derr:</b> nënkupton kafshët shtëpiake të species <i>Sus scrofa domestica</i>.</p> <p><b>Dhen:</b> nënkupton kafshët shtëpiake të species <i>Ovis aries</i>.</p> <p><b>Dhi:</b> nënkupton kafshët shtëpiake të species <i>Capra aegagrus hircus</i>.</p> <p><b>Shpendë:</b> nënkupton zogjtë shtëpiake të species <i>Gallus gallus</i> (pulat), <i>Meleagris</i> spp. (pulat/gjelat e detit), <i>Anas</i> spp. dhe <i>Cairina moschata</i> (rosat), si dhe <i>Anser anser dom.</i> (patat). Shpendët shtëpiake të species <i>Coturnix</i> spp. (thëllëzat), <i>Phasianus</i> spp. (fazanët), <i>Numida meleagris dom.</i> (pulëhinet), <i>Columbinae</i> spp. (pëllumbat) dhe <i>Struthio camelus</i> (strucët). Megjithatë, këtu nuk përfshihen zogjtë e rritur në ambiente të izoluar për qëllime gjuetie dhe jo për prodhimin e mishit.</p> <p><b>Prodhim mishi peshë e gjallë:</b> Vlerësimi për prodhimin e mishit peshë e gjallë kryhet për çdo lloj kafshe. Llogaritja e prodhimit të mishit peshë e gjallë bazohet në përlllogaritjet e bëra nga lëvizja e blegtorisë, pra në numrin e krerëve të skartuar për gjedhë, të leshta, të dhirta, derra, dhe shpendë, sipas kategorive të therjes, dhe në peshën e gjallë mesatare për krerë të therur sipas llojeve dhe kategorive të therjes.</p> <p><b>Prodhimi i qumështit:</b> Prodhimi i qumështit përfshin qumështin nga: lopët, delet dhe dhitë. Prodhimi i qumështit përfshin të gjithë qumështin që prodhohet ekskluzivisht për konsum popullate të freskët ose për prodhimin e nënprodukte të qumështit si djathë, gjalpë gjizë, kos, në fermë apo në fabrika dhe baxho që e përpunojnë. Qumështi i mjelë me dorë apo me makina mjelëse dhe u jepet viçave me kovë përfshihet në prodhim qumështi.</p> <p><b>Shënim:</b> Qumështi që pijnë të vegjëlit direkt nga gjiri i mëmës, (si viçat e posa lindur që pijnë direkt nga lopa) nuk llogaritet në prodhim qumështi. Kjo llogaritet në shtesë mishi peshë e gjallë.</p> <p><b>Prodhimi vezëve:</b> përfshihen të gjitha vezët që prodhohen për konsum popullate. Përfshihen vezët që prodhohen në njësitë ekonomike bujqësore, fermat e pularive dhe ato nga Agroindustria.</p> <p><b>Prodhimi i mjaltit:</b> përfshin të gjithë mjaltin e prodhuar nga çdo koshere.</p>

	<b>Prodhimi i leshit:</b> përfshin prodhim leshi nga të leshta dhe prodhim leshi nga të dhirtat.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e vrojtuar është Njësia Ekonomike Bujqësore (NJEB).
3.6. Popullata statistikore	Të dhënat për numrin e krerëve dhe prodhimet blegtorale grumbullohen nga të gjitha NJEB-të (Njësitë Ekonomike Bujqësore) të cilat kanë si fokus të tyre mbarështrimin e kafshëve.
3.7. Zona e referencës	Statistikat e blegtorisë mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat për numrin e krerëve datojnë që nga viti 2001, ndërsa për prodhimet blegtorale datojnë që nga viti 2004.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
<b>4. Njësia matëse</b>	Njësia matëse e përdorur është ton, numër krerësh.
<b>5. Periudha e referencës</b>	Periudha e referencës për prodhimet blegtorale fillon nga data 01 Dhjetor 2022–30 Nëntor 2023. Për numrin e krerëve periudha e referencës është vetëm 1 ditë e vitit, ditë referuese është data 01 Dhjetor 2023.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Baza ligjore për mbledhjen e Statistikave të Blegtorisë janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligjin Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare"</a>;</li> <li>• <a href="#">Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026</a>;</li> <li>• <a href="#">RREGULLORE (KE) NR.1165/2008</a> “Për statistikat e blegtorisë dhe mishit”.</li> </ul> </li> <li>➤ Klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së. <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Rregullorja Nr. 1165/2008</a> në lidhje me statistikat e blegtorisë dhe mishit;</li> <li>• <a href="#">Rregullorja e Komisionit (EC) Nr 1242/2008</a> mbi tipologjinë e njësive Bujqësore;</li> <li>• <a href="#">NACE Rev.2</a> - Klasifikimi statistikor i veprimtarive ekonomike.</li> </ul> </li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Blegtorisë transmetohen në EUROSTAT nëpërmjet platformës eDAMIS.
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga NJEB konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare

	<p>përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
<p>7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerret të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<p><b>8. Politika e botimit</b></p>	
<p>8.1. Kalendarin e publikimeve</p>	<p>Njoftimet për shpërndarjen e statistikave publikohen në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë parashpallur në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
<p>8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve</p>	<p><a href="#">Kalendari i publikimeve</a> është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>
<p>8.3. Aksesin i përdoruesve</p>	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme të mediave. INSTAT dhe agjencitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individit për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p>

	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. <a href="#">Website</a> – online release;</li> <li>2. Kërkesat e shkruara;</li> <li>3. Publikimi;</li> <li>4. <a href="#">Kërkesa për të dhëna</a>, seksioni për përdoruesit e jashtëm.</li> </ol>
<b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>	Statistikat e Blegtorisë publikohen në baza vjetore.
<b>10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	<p>Njoftim për shtyp përmban informacion mbi treguesit kryesorë si: gjethë, shpendë, qumësht etj.</p> <p>Formati i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos dhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp për Statistikat e Blegtorisë publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.</p>
10.2. Publikime	<p>Rezultatet e Statistikave të Blegtorisë janë botuara në faqen e internetit të INSTAT në botimin: “Statistikat e Blegtorisë”, “Vjetarin Statistikor”, “Vjetari Rajonal Statistikor” dhe “Shqipëria në Shifra”.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Statistikat e Blegtorisë</a>;</li> <li>• <a href="#">Vjetarin Statistikor</a>;</li> <li>• <a href="#">Vjetari Rajonal Statistikor</a>;</li> <li>• <a href="#">Shqipëria në Shifra</a>.</li> </ul>
10.3. Baza e të dhënave on-line	<p>Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni më poshtë: <a href="#">Databaza Statistikore</a>.</p>
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	<p>Të dhënat mbi Statistikat e Blegtorisë janë të dhëna administrative dhe si të tilla niveli më i detajuar i të dhënave që merren është në nivel bashkie. Pra, INSTAT nuk disponon të dhëna në nivel mikro për Statistikat e Blegtorisë.</p>
10.5. Të tjera	<p>Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike për Statistikat e Blegtorisë nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kërkesë të dhënash</a>.</p>
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	<p>Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">metodologjinë</a> mbi Statistikat e Blegtorisë.</p>
10.7. Dokumentimi i cilësisë	<p>Sektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi Statistikat e Blegtorisë për qëllime të brendshme.</p>

## 11. Manaxhimi i cilësisë

### 11.1. Sigurimi i cilësisë

INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “[Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018](#), INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane ([European Statistics Code of Practice](#)). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.

### 11.2. Vlerësimi i cilësisë

Të dhënat blegtorale grumbullohen për numrin e kafshëve që mbarështojnë fermerët si dhe prodhimet blegtorale. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë të dhëna për t’i krahasuar dhe me të dhënat e shërbimit veterinar i cili kryen matrikullimin dhe vaksinimin e kafshëve. Shërbimi veterinar kryen në momentin e vaksinimit inventarin e kafshëve në nivel komune. Specialistët e ekstensionit kanë marrëdhënie dhe me veterinerët privatë. Këta veterinerë kryejnë shërbime të ndryshme në mënyre private pranë fermerëve (si kontroll nga sëmundjet, ngordhje të kafshëve apo lindje, therje, vaksinime etj). Në fund specialistët e ekstensionit krahasojnë të dhënat nga të tre burimet. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë gjithashtu të dhëna për prodhimet bujqësore dhe blegtorale nga fermerët. Të dhëna për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuese në nivel bashkie. Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit blegtoral bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave në vite.

## 12. Rëndësia

### 12.1. Nevojat e përdoruesit

Përdoruesit e Statistikave të Blegtorisë ndahen në përdorues të brendshëm dhe të përdorues të jashtëm.

- Përdorues të jashtëm:
  - Institucione të administratës publike;
  - Universitetet;
  - Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - Bizneset;
  - Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme.
- Përdorues të brendshëm:
  - Drejtoria e Llogarive Kombëtare;
  - Drejtoria e Statistikave Ekonomike;
  - Drejtoria e Statistikave Sociale;
  - Drejtoria e Statistikave Sektoriale;

të cilët përdorin statistikave të blegtorisë si input në punën e tyre.



12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>INSTAT analizon çdo vit klikimet e faqes web dhe klikimet në lidhje me temën “Statistikat e Blegtorisë” për vitin 2023 janë 3,416.</p> <p>INSTAT organizon cdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p> <p>Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës “Statistikat e Blegtorisë” është vlerësuar me 3.88 (77.6%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p>															
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave për statistikën e blektorisë dhe produkteve blektorale për vitin 2023 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloreve të ndjekura.</p> <p>Niveli i plotshmërisë të treguesve në nivel të agreguar është në përputhje të plotë me rregulloren: “Regulation (EC) No 1165/2008”, dhe si të tillë raportohen të gjithë treguesit që kërkohen nga Eurostat. Niveli i detajimit të këtyre treguesve të prodhuar nga INSTAT realizohet nëpërmjet metodave vlerësuese të ekspertëve të fushës.</p>															
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>																
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Informacioni mbi Statistikat e Blegtorisë grumbullohet nga burimet administrative, sipas detyrimit të zbatimit të bazës ligjore dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit në fuqi.</p> <p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishme në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton MBZHR për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të bëra në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.</p>															
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.															
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm njerëzor. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.</p>															
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>																
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Statistikave të Blegtorisë publikohen (T+204 ditë) dhe (T+203 ditë) pas periudhës referuese. Më poshtë janë marrë parasysh dy periudha të ndryshme referuese për fushat përkatëse mbi të cilat mbështeten këto rezultate.</p> <table border="1" data-bbox="448 1912 1398 2067"> <thead> <tr> <th>Statistikat e Blegtorisë</th> <th>Fusha Statistikore</th> <th>Periudha referuese</th> <th>Data e publikimit</th> <th>Afatet kohore</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>Prodhimet Blegtoriale</td> <td>11/30/2023</td> <td>6/21/2024</td> <td>204</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Numri i Krerëve</td> <td>12/1/2023</td> <td>6/21/2024</td> <td>203</td> </tr> </tbody> </table>	Statistikat e Blegtorisë	Fusha Statistikore	Periudha referuese	Data e publikimit	Afatet kohore		Prodhimet Blegtoriale	11/30/2023	6/21/2024	204		Numri i Krerëve	12/1/2023	6/21/2024	203
Statistikat e Blegtorisë	Fusha Statistikore	Periudha referuese	Data e publikimit	Afatet kohore												
	Prodhimet Blegtoriale	11/30/2023	6/21/2024	204												
	Numri i Krerëve	12/1/2023	6/21/2024	203												



14.2. Përpikmëria	Të gjitha afatet kohore respektohen në datat e paracaktuara në kalendarin e botimeve. Publikimi i të dhënave si pjesë e botimeve të ndryshme të INSTAT, ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100% të publikime të kryera.					
	Statistikat e Blegtorisë	Fusha Statistikore	Periudha referuese	Data e shpallur	Data e publikimit	Vonesa në kohë
		Prodhimet Blegtoriale	11/30/2023	6/21/2024	6/21/2024	0
	Numri i Krerëve	12/1/2023	6/21/2024	6/21/2024	0	
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>						
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi Statistikat e Blegtorisë janë gjithë përfshirëse, ato prodhohen në nivel vendi dhe sipas bashkive. Statistikat krahasohen sipas shpërndarjes gjeografike dhe rajonizimit të produkteve blegtoriale.					
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Të dhënat mbi numrin e krerëve datojnë që nga viti 2001 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 23 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=23).</p> <p>Ndërsa të dhënat mbi prodhimet blegtoriale datojnë që nga viti 2004 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 20 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=20).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>					
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.					
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të ndryshme.					
<b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b>	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave të blegtorisë pranë sektorit të Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit është: 2 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT, pasi të dhënat e statistikave të blegtorisë sigurohen nga burime administrative të Drejtorive të Bujqësisë në qarqe në bashkëpunim me Sektorin e Statistikës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.					
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>						
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit;</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve.</a></li> </ul>					
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Blegtorisë do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të					

	<p>përditësohet dhe publikohet në publikimin e muajit të ardhshëm shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit.</p> <p>Nuk ka rishikime deri tani mbi të dhënat e statistikave të Blegtorisë, për vitin 2023, subjekt i këtij raporti.</p>
<b>18. Përpunimi statistikor</b>	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Për prodhimin e statistikave të Blegtorisë, INSTAT përdoret informacionin e siguruar nga burime administrative përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.</li> </ul>
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat e Statistikave të Blegtorisë mblidhen në bazë vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave të Blegtorisë për vitin 2023, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave u janë bërë kontrolle logjike dhe matematike. Këto kontrolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet. Të dhënat e blektorisë sigurohen nga burimi administrativ, në nivel vendi, qarku dhe bashkie. Informacioni statistikor mundësohet në kohë.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
<b>19. Komente</b>	
<b>Aneks</b>	